



Zyra e Kryetarit

02 Nr. ___ /2026 Dt. 05 / 01 /2026

Në bazë të nenit 56 pika 2 dhe pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, **duke u bazuar në Vendimin nr. 02/15096, të datës 15.05.2024**, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

- 1. Ndryshohet pika 1 e Vendimit**, në atë mënyrë që shpenzimet e varrimit do të mbulohen **vetëm për familjet përfituese të asistencës sociale në Komunën e Deçanit**, sipas kërkesave të paraqitura nga anëtarët e ngushtë të familjes së personit të vdekur, të drejtuara Zyrës së Kryetarit, nga kategoria e subvencioneve, në vlerë prej **200 (dyqind) euro**.
- 2. Të drejtë për përfitim të këtij subvencioni kanë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes së personit të vdekur**, me kusht që familja të jetë përfituese e asistencës sociale.
- 3. Me kërkesën për përfitim duhet të bashkëngjiten këto dokumente:**
 - Certifikata e vdekjes;
 - Certifikata e Bashkësisë Familjare;
 - Kopje e letërnjoftimit të aplikuesit;
 - Konfirmimi i llogarisë bankare të aplikuesit;
 - Fatura nga institucioni fetar;
 - Dëshmi/konfirmim nga Qendra për Punë Sociale që familja është përfituese e asistencës sociale.
- 4. Të gjitha dispozitat e tjera të Vendimit, të cilat nuk janë ndryshuar me këtë vendim, mbesin në fuqi.**
- 5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.**

Me vendim njoftohen:

- Zyra e Kryetarit;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Arkivi Komunal.

Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosaj



Z. Kryetarit 106

02

05-01-26



Zyra e Kryetarit

02 Nr. ___ /2026 Dt. 05 / 01 /2026

Në bazë të nenit 56 pika 2 dhe pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për subvencionimin e nënave lehona

1. Komuna e Deçanit do të subvencionojë të gjitha nënat që lindin fëmijë, me banim në territorin e Komunës së Deçanit, me subvencion financiar në vlerë prej 300 (treqind) euro për çdo lindje.
2. E drejta për përfitimin e këtij subvencioni u takon nënave lehona, pavarësisht numrit të lindjeve, me kusht që lindja të jetë e regjistruar në organet kompetente.
3. Për përfitimin e subvencionit, me kërkesë duhet të bashkëngjiten këto dokumente:
 - Certifikata e lindjes së fëmijës;
 - Certifikata e Bashkësisë Familjare ose dëshmi e vendbanimit në Komunën e Deçanit;
 - Kopje e letërnjoftimit të nënës;
 - Konfirmimi i llogarisë bankare të nënës.
4. Mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Deçanit, nga kategoria e subvencioneve.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës dhe zbatohet për të gjitha lindjet që ndodhin pas hyrjes së tij në fuqi.

Me vendim njoftohen:

- Zyra e Kryetarit;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Arkivi Komunal.

Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosaj



Z. Kryetarit

108

02

05.01.26



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. ____ /2026

Dt. 08 / 01 / 2026

Në mbështetje të nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/04 Qershor 2008), nenit 90 dhe 91 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera (04/L-027), nenit 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe nenit 9 të Rregullores për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë tjera (nr.15/2015), si dhe në bazë të nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kryetari i Komunës së Deçanit, merr këtë :

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSITE NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA NË KOMUNEN E DEÇANIT

I.

Themelohet komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në përbërje si në vijim:

1. Gentiana Mazrekaj – Kryetare e Komisionit
2. Shaban Haxhaj – Anëtar
3. Blerta Gjocaj - Anëtare
4. Bajram Dervishaj – Anëtar
5. Afrim Hasanmetaj – Anëtar

II

Detyrë e komisionit është që të bëjë vlerësimin e të gjitha dëmeve që shkaktohen nga të gjitha fatkeqësitë natyrore në tërë territorin e Komunës së Deçanit, në çdo kohe gjatë tërë vitit. Komisioni paraprakisht duhet të viziton të gjitha pronat e pronarëve të cilët i janë drejtuar Komisionit me kërkesë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Komisioni pas grumbullimit të të dhënave duhet të bëjë vlerësimi e dëmeve të konstatuara për çdo rast veç e veç.

III

1. Organizon numrin e nevojshëm të komisioneve profesionale për vlerësimin e dëmeve dhe përcakton zonën përkatëse për secilin komision. Në rastet e dëmeve të përmasave të vogla vlerësimin e dëmeve e kryen vet komisioni lokal;
- 1.1 Cakton afatin deri kur duhet të kryhet vlerësimi i dëmeve;

1.2 kujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje ;

1.3 bashkon punën e të gjitha komisioneve profesionale në territorin e komunës dhe iu ofron ndihmën e nevojshme profesionale;

1.4 përpilon raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës dhe ia dorëzon kryetarit të komunës për shqyrtim;

1.5 raportin e shqyrtuar e dërgon në asamble komunale për miratim dhe ia dorëzon Agjencisë në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit dhe një kopje ia dorëzon komisionit qendror.

1.6 mbanë evidencë për dëmet e shkaktuara në territorin e komunës.

IV


Mandati i komisionit të cekur sipas pikës I të këtij Vendimi është me kohëzgjatje me mandatin e kryetarit.

V

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Zyrës së kryetarit
- Arkives



KRYETARI I KOMUNËS
Bashkim Ramosaj






Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të bazuar në performancë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.23/ 12 Gusht 2022), nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008) dhe nenit 56 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, dt.31.10.2019, Kryetari i Komunës së Deçanit merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT PËR PERFORMANCË TË KOMUNËS SI DHE ZYRTARËT PËRGJEGJËS RAPORTUES PËR FUSHAT E PERFORMANCËS SË KOMUNËS

- I. Me këtë Vendim, Kryetari cakton Koordinatorin për performancë të komunës, si dhe zyrtarët përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës:
 1. Manjolla Shala, Koorditore për performancë të komunës;
 2. Edone Kameraj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 3. Zoje Selmonaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 4. Ramiz Bajramaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 5. Ajne Iberhysaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 6. Blerta Gjocaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 7. Yll Mazrekaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 8. Isuf Demhasaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 9. Setki Mushkolaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 10. Afrim Hasanmetaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 11. Gentiana Iberhysaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 12. Albana Avdiu, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
 13. Riza Gjokokaj, zyrtar përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës;
- II. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Koordinatorit për performancë të komunës, si dhe zyrtarëve përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës janë:
Kordinatori për performancë është përgjegjës për koordinimin e procesit të raportimit me zyrtarët raportues të fushave të SMPK-së, zbatimin e kriterëve për verifikim dhe raportimin e të dhënave të cilat i dërgohen kryetarit të komunës për miratim.
- III. Për punën dhe angazhimet e veta Koordinatori për performancë të komunës, si dhe zyrtarët përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës do të kompensohen nga buxheti komunal, të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i dt. 05 Janar 2023.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit.
- V. Me vendim njoftohen:
 1. Të caktuarit në pikën I. të Vendimit dhe
 2. Arkivi i komunës

02.Nr. _____
Dt.16.01.2026



Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj





Zyra e Kryetarit

02 Nr. ___ /2026 Dt. 05 / 01 /2026

Në bazë të nenit 56 pika 2 dhe pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për subvencionimin e personave me sëmundje malinje

1. Komuna e Deçanit do të subvencionojë **personat me sëmundje malinje**, me banim në territorin e Komunës së Deçanit, me subvencion financiar, në vlerë prej **500 (pesëqind) euro**.
2. Subvencioni nga pika 1 e këtij vendimi **jepet vetëm një herë brenda një viti kalendarik për secilin përfitues** dhe nuk paraqet pagesë mujore apo të përsëritur.
3. E drejta për përfitimin e këtij subvencioni u takon personave të diagnostikuar me sëmundje malinje, me kusht që diagnoza të jetë e vërtetuar nga institucionet shëndetësore kompetente dhe përfituesi të ketë vendbanim në Komunën e Deçanit.
4. Për përfitimin e subvencionit, me kërkesë duhet të bashkëngjiten këto dokumente:
 - Dëshmi mjekësore (raport/konfirmim) nga institucioni shëndetësor kompetent për sëmundjen malinje;
 - Certifikata e vendbanimit ose e Bashkësisë Familjare;
 - Kopje e letërnjoftimit të përfituesit;
 - Konfirmimi i llogarisë bankare të përfituesit.
5. Mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Deçanit, nga kategoria e subvencioneve.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Me vendim njoftohen:

- Zyra e Kryetarit;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Arkivi Komunal.

Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosaj



Z. Kryetari

104

02 Faqe 1 / 1

05.01.26



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të nenit 7 paragrafi 7.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), nenit 11 të Ligjit nr.03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës, nenit 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2009 për Vulën rrethore, nenit 9 pika 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kryetari i Komunës së Deçanit, me dt.28.01.2026, merr këtë:


V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MARRJEN E LEJES PËR VULË PËR DËSHMINË E VDEKJES

- I. Themelohet Komisioni Komunal për zhvillimin e procedurave për marrjen e lejes për vulë për dëshminë e vdekjes, të cilat lëshohen në Komunën e Deçanit, në këtë përbërje:
 1. Jashar Dobraj, drejtor i Drejtorisë për Adiministratë, Kryetar i Komisionit,
 2. Hate Shehu, Shefe e Drejtorisë për Administratë, antare e komisionit,
 3. Dyke Llloluni, Udhëheqëse Sektorit për punë të Kuvendit, antare e Komisionit,
- II. Përgjegjësitë e Komisionit Komunal për zhvillimin e procedurave për marrjen e lejes për vulë për dëshminë e vdekjes, të cilat lëshohen në Komunën e Deçanit, janë si në vijim:
Komisioni zhvillon të gjitha procedurat për marrjen e lejes për vulë, porositjen e vulës te vulëpunuesi, mbikqyrjen e punës së vulëpunuesit, arkivimin e vulës, shpalljen e pavlefshme të vulës dhe veprime të tjera të parapara me ligjin Nr.03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009 për Vulën rrethore.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.
- IV. Me vendim paisen:
 1. Të emruarit në pikën I. të Vendimit, dhe
 2. Arhivi i Komunës së Deçanit.

02.Nr. _____

Deçan, dt.28.01.2026



Kryetari i Komunës
Bashkim RAMOSAJ

